



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGIISE

**VENDIM**

*Nr. 160 Datë 26.11.2012*

**MBI**

**ANKIMIN ADMINISTRATIV TË KESH SH.A DHE CEZ  
SHPERNDARJE SH.A NË LIDHJE ME VENDIMIN NR. 134, DATË  
17.09.2012 “PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FURNIZIMIT ME  
ENERGJI ELEKTRIKE MIDIS SHOQËRISË KESH SH.A/FPSH DHE  
SHOQËRISË CEZ SHPËRNDARJE SH.A/FPP PËR PERIUDHËN  
01.01.2012 – 31.12.2014”**

Në mbështetje të nenit 16 pika 3, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE, të miratuar me Vendimin nr. 21, Datë 18.03.2009, Bordit të Komisionerëve të ERE, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 26.11.2011, pasi u njoh me ankesën e shoqërisë KESH sh.a dhe CEZ Shpërndarje sh.a, mbi Vendimin nr. 134, datë 17.09.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE mbi kontratën për furnizimin me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a (Furnizuesi Publik me Shumicë) dhe shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a (Furnizuesit Publik me Pakicë) për periudhën 01.01.2012 deri më 31.12.2014 si dhe relacionin e përgatitur nga Drejtorite Teknike të ERE

**Vendosi:**

1. Te pranojë kërkesën e shoqërisë KESH sh.a për të përket propozimit të parashikimit të një reference të sakte për rastet kur kjo shoqëri nuk ka bërë import. Si rrjedhojë pika 8.3.ii e Kontratës, riformulohet:

“Në rastin e importit të një sasi me të vogël se humbjet reale në rrjetin e shpërndarjes, CEZ Shpërndarje do të kompensojë këtë sasi të energjisë elektrike të siguruar nga KESH sh.a, deri në fund të muajit m+2. Në rast se kompensimi nuk kryhet brenda periudhës m+2, CEZ Shpërndarje sh.a është i detyruar të kompensojë KESH sh.a në muajin m+3, me vlerën monetare që i korrespondon kostove reale të shkaktuara dhe të identifikuar nga KESH sh.a për sigurimin e kësaj sasi të energjisë elektrike. Në mungesë të importit të energjisë elektrike nga ana e KESH sh.a, për muajin përkatës, kompensimi do bëhet me vlerën monetare që i

korrespondon cmimit të importit vjetor të energjise elektrike të shoqerise CEZ Shperndarje sh.a.”;

2. Të rrëzojë pjesen tjetër të kërkesës së KESH sh.a si të pabazuar në prova të reja që mund të çojnë Bordin e Komisionereve të ERE-s në një vendim të ndryshëm nga ai i marrë në datë 17.09.2012.
3. Të pranojë kërkesen e shoqerise CEZ Shperndarje persa i perket propozimit të parashikimit të drejtës së kësaj shoqerie që të blejë gjithë energjinë elektrike për furnizimin e konsumatoreve tarifore me cmim të rregulluar. Si rrjedhojë pika 8.2 e Kontrates, riformulohet:  
  
“Cdo sasi e energjie elektrike e livruar për furnizim të konsumatoreve tarifore me teper nga ajo e planifikuar nga ana e pales pranuese duhet t’i paguhet pales livruese me cmim të rregulluar”
4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë Shoqerite KESH sh. dhe CEZ Shperndarje mbi vendimin e Bordit të Komisionereve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGIISE

**VENDIM**

*Nr. 160 Datë 26.11.2012*

**MBI**

**ANKIMIN ADMINISTRATIV TË KESH SH.A DHE CEZ SHPËRNDARJE SH.A NË LIDHJE ME VENDIMIN NR. 134, DATË 17.09.2012 “PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE MIDIS SHOQËRISË KESH SH.A/FPSH DHE SHOQËRISË CEZ SHPËRNDARJE SH.A/FPP PËR PERIUDHËN 01.01.2012 – 31.12.2014”**

**Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,**

**Anëtarët e Bordit**

	<b>Pro</b>	<b>Kundër</b>
<b>Sokol Ramadani</b>	_____	_____
<b>Ardian Haçi</b>	_____	_____
<b>Abaz Aliko</b>	_____	_____
<b>Shkëlqim Bozgo</b>	_____	_____

